

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Kuvendi Komunal Prishtinë**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr.i AP: **616-26-1322-2-1-1**

Sa i përket tenderit për: **81 Mirëmbajtja e ndërtesave të IEA – Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve shkollore dhe kopshteve-Lot II**

ANKESË

1. Identifikimi i Ankuesit:

INTERNATIONAL SECURITY AAH SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

RR.REXHEP BISLIMI NR.1

(Adresa)

FERIZAJ

(Vendi)

70 000

(Kodi postar)

044/500-662

(Numri Telefonit)

NUK APLIKOHET

(Numri i Faks-it)

KUMRIE SYLA

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

ahh.international@gmail.com

(Adresa elektronike)

19.05.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimt të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Lënda: *Shërbime*

Procedura e prokurimit: *Procedurë e hapur*

FPP fjalori kryesor: *93000000-8 Shërbime të ndryshme*

Vlera e parashikuar: *3,984,000.00€ (e madhe)*

B05 Njoftimi për Kontratë

Data: 17.03.2026 13:11

B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara

Data: 03.04.2026 09:18

B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara

Data: 10.04.2026 17:35

B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara

Data: 20.04.2026 11:32

Afati për dorëzimin e tenderëve:

Data: 30.04.2026 – Ora: 14:00

► Hapja e ofertave – Procesverbali i hapjes:

30.04.2026 – Ora 14:56

Njoftimi mbi vendimin e AK-së:

Data: 07.05.2026 15:50

Kriteri për dhënien e kontratës:

√ Çmimi më i ulët

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Jo, nuk kemi marr pjesë, hapja e ofertave është bërë në mënyrë elektronike përmes platformës së E-prokurimit.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

Po, e kemi pranuar letrën standarde përmes publikimit të Njoftimit mbi vendimin e AK-së me datën 07.05.2026.

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Po, me datën 12.05.2026 përmes platformës së E-prokurimit. Me datën 14.05.2026 nëpërmjet platformës së E-prokurimit, AK kthen vendim mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim si të pabazuar.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- Legjislacioni primar -

1. Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.

- Neni 1 - Qëllimi,
- Neni 6 - Ekonomiciteti dhe efikasiteti,
- Neni 7 - Barazia në trajtim / Jo-diskriminimi,
- Neni 10 - Mjetet për promovimin e Transparencës,
- Neni 28 - Specifikimet teknike,
- Neni 31 - Ekzekutimi i kontratave,
- Neni 51 - Njoftimi i kriterëve të përzgjedhjes,
- Neni 52 - Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës,
- Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve,
- Neni 72 - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë,
- Neni 108/A - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve.

- Legjislacioni sekondar –

2. Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik

- Neni 17 - Dosja e tenderit,
- Neni 25 - Kriteret e përzgjedhjes,
- Neni 27 - Kriteret e dhënies së kontratës,
- Neni 38 - Sqarimi i Tenderëve,
- Neni 40 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve,
- Neni 45 - Procedura e Hapur,
- Neni 61 - Pezullimi i aktivitetit të prokurimit,
- Neni 62 - Refuzimi i një kërkesë për shqyrtim.

- Ligji i Punës Nr.03/L-212 -

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

ANKESË

Në afatin e lejuar ligjor, në mbështetje të **Nenit 109** të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe **Nenit 4.1.26 të LPP-së**, Operatori Ekonomik: International Security AAH sh.p.k., në cilësinë e palës së interesit, paraqet këtë Ankesë lidhur me procedurën e prokurimit:

Titulli: “81 Mirëmbajtja e ndërtesave të IEA - Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve shkollore dhe kopshteve - Lot II”

Nr. prokurimit: 616-26-1322-2-1-1

Nr. i brendshëm: 616-26-9-2-1-1

1. Autoriteti Kontraktues gjatë fazës së kërkesës për rishqyrtim nuk e ka pezulluar aktivitetin e prokurimit, edhe përkundër se një gjë të tillë e obligojnë dispozitat ligjore të Nenit 61.1. të Rregullores Nr.001/2022 dhe par.2 i Nenit 108/A të LPP-së.

2. Autoriteti Kontraktues nuk iu është përgjigjur pretendimeve tona ankimore, ajo përmes një vendimi refuzon si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim, duke mos u arsyetuar fare për asnjë pretendim tonin ankimor, edhe pse e ka obligative.

3. Autoriteti Kontraktues ka vepruar me standarde të dyfishta për shkak se për të njejtën procedurë Operatorit Ekonomik të rekomanduar për kontratë i ka kërkuar sqarime në bazë të Nenit 72 të LPP-së me datën 06.05.2026, kjo vërehet përmes komunikimeve të tyre gjatë vlerësimit të ofertave, kurse kompanisë sonë nuk i ka kërkuar as edhe një kërkesë të vetme për sqarim apo plotësim të ndonjë dokumenti.

I. LIDHUR ME ARSYEN E ELIMINIMIT PËR MENAXHERIN E RISKUT DHE PAGËS 600 EURO

Pretendimi i Autoritetit Kontraktues për eliminim se OE nuk ka paraqitur dëshmi për pagën mujore prej 600 euro bruto për menaxherin e riskut sipas standardeve ISO dhe se kjo nuk është përfshirë në analizën financiare **është plotësisht i pabazuar**, i pasaktë dhe në kundërshtim me Dosjen e Tenderit dhe LPP-në.

Në Dosjen e Tenderit, tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, si dëshmi është kërkuar qartë vetëm:

- diploma e shkollës së mesme,
- certifikata ISO 31000 (për Lot II).

Asnjë kërkesë në Dosjen e Tenderit nuk kërkon që paga e menaxherit të riskut të përfshihet në analizën financiare.

Kompania jonë ka vepruar "**strictus secundum**" dosjen e tenderit, duke përfshirë në analizë vetëm ato elemente për të cilat është dhënë **kërkesa eksplicite**. Nëse Autoriteti Kontraktues do të kishte kërkuar shprehimisht përfshirjen e pagës së menaxherit të riskut në analizën financiare, ne si OE do ta kishim përfshirë pa asnjë hezitim, **ashtu siç ishte kërkuar përfshierja e pagës së menaxherit në vlerën prej 700 euro bruto, e për të cilin ne si ofertues e kemi përfshirë në analizën financiare** sipas kërkesës së AK-së në dosjen e tenderit.

Prandaj, pretendimi i AK është:

- i krijuar pas dorëzimit të ofertave,
- i pabazuar në Dosjen e Tenderit, dhe
- qartësisht diskriminues dhe tendencioz ndaj OE-së tonë.

Kjo përbën shkelje të drejtpërdrejtë të **Nenit 40.2 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik**, i cili përcakton se:

“Autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kritere ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.”

Rrjedhimisht, ky kriter i aplikuar "**ex post**" është i paligjshëm dhe i pavlefshëm juridikisht.

II. LIDHUR ME ANALIZËN FINANCIARE (PUSHIMI VJETOR)

Pretendimi se analiza financiare është e pasaktë për shkak të llogaritjes së pushimit vjetor me 20 ditë dhe 160 orë në vend të 22 ditëve dhe 176 orëve është plotësisht i pabazuar në ligj dhe në Dosjen e Tenderit.

Në kërkesën e AK është kërkuar vetëm përfshirja e pushimit vjetor në analizë, **pa asnjë specifikim për metodologjinë e llogaritjes së orëve.**

Sipas Ligjit të Punës Nr. 03/L-212:

Neni 32 paragrafi 1:

“I punësuari gjatë çdo viti kalendarik ka të drejtë për pushim vjetor të paguar në një kohëzgjatje prej së paku katër (4) javë, pavarësisht a punon me orar të plotë apo të shkurtuar.”

Neni 20, paragrafi 2:

“Orari i plotë i punës zgjat dyzet (40) orë në javë, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.”

Nga këto dispozita rrjedh qartë se:

$40 \text{ orë/javë} \div 5 \text{ ditë në javë} = 8 \text{ orë/ditë}$

$4 \text{ javë pushim} = 20 \text{ ditë pune}$

$20 \text{ ditë} \times 8 \text{ orë} = 160 \text{ orë pushim vjetor}$

Pra, kalkulimi i OE është:

- ligjor,
- matematikisht i saktë,
- i bazuar në normën minimale ligjore.

Pretendimi i AK për 22 ditë / 176 orë:

- nuk mbështetet në asnjë dispozitë ligjore,
- nuk është kërkuar në Dosjen e Tenderit,
- përbën kriter shtesë pas dorëzimit të ofertave.

Kjo është në kundërshtim me Nenin 40.13 të Rregullores 001/2022 për Prokurimin Publik, i cili përcakton:

“Komisioni vlerësues do t'i vlerësojë dhe krahasojë tenderët e përgjegjshëm sipas kriterëve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit.”

III. LIDHUR ME PËRSHKRIMIN E ÇMIMIT (FORMATI EXCEL DHE NËNSHKRIMI/VULA)

Pretendimi se përshkrimi i çmimit nuk është i nënshkruar, i vulosur dhe nuk përmban çmimin përfundimtar është juridikisht i pabazuar dhe në kundërshtim të drejtpërdrejtë me rregullat e LPP-së dhe e-prokurimit.

Sipas Nenit 17.9 të Rregullores për Prokurimin Publik:

“Gjatë përgatitjes dhe dorëzimit të tenderëve, OE nuk kërkohet të nënshkruajnë manualisht formularin e tenderit (i cili gjenerohet nga sistemi) dhe **listën e çmimeve**, pavarësisht se a është përdorë Lista e çmimeve standarde ose jo-standarde.”

Po ashtu, Neni 17.8 të Rregullores 001/2022 përcakton qartë:

“Për të gjitha procedurat e përgatitura përmes platformës elektronike, AK duhet të përdorin vetëm Listën e çmimeve standarde e cila krijohet nga sistemi ose jo-standarde **në formatin excel** e cila krijohet nga vetë përdoruesi. Në sistem të prokurimit elektronik dosja e tenderit dhe lista e çmimeve publikohen si dokumente të ndara.”

Oferta jonë përfshin të gjitha çmimet përfshirë edhe atë përfundimtar në listën e çmimeve në dokumentin e AK-së në formatin excel.

Rrjedhimisht:

- dorëzimi në Excel është plotësisht i ligjshëm,
- nuk kërkohet nënshkrim manual i dokumenteve të lartëcekura,
- pretendimi për pavlefshmëri është kontradiktor me vetë rregulloren.

Për më tepër, është shqetësues fakti se:

- OE të rekomanduar për kontratë iu është pranuar me dokumente në format PDF duke krijuar rrezik për manipulim të çmimeve me decimalë shtesë, gjë që cenon parimin e transparencës dhe trajtimit të barabartë sipas qëllimit, konkretisht nenit 1 dhe 6 të LPP-së.

IV. LIDHUR ME MUNGESËN E FOTOGRAFIVE TË PAJISJEVE (ANEKSI 7)

Pretendimi për mungesë të fotografive të mjeteve është i pabazuar në Dosjen e Tenderit.

Kërkesa e AK ka qenë qartë:

- listë pajisjesh,
- DUD (deklarata unike doganore),
- kontrata / fatura blerjeje,
- libreza automjetesh,
- marrëveshje shfrytëzimi (kur aplikohet).

OE ka dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara në mënyrë të plotë dhe të verifikueshme, duke bashkangjitur të gjitha dëshmitë e kërkuara.

Asnjë pjesë e Dosjes së Tenderit nuk ka kërkuar obligativisht fotografi të pajisjeve si kriter eliminues.

Për më tepër, sipas Nenit 38.3 dhe 38.4 të Rregullores 001/2022 për Prokurimin Publik:

“Megjithatë, lejohet që një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkojë dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyrë objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve.”

"Autoriteti kontraktues do të sigurojë mundësinë e sigurimit të informacionit shtese në kushte të njëjta për të gjithë Operatorët ekonomik dhe do të kërkojë informacion nga Operatorët Ekonomik me qëllim të qartësisimit të përmbajtjes së deklaratave të paqarta, çertifikatave të përfshira në tenderë apo kërkesave për pjesëmarrje. Sqarimi dhe kërkesa për informacion shtesë, informacion plotësues dhe dokumente është pjesë e procedurës së vlerësimit. Kërkesa kalon / nuk kalon dhe vlefshmëria e ofertave/aplikacioneve mund të vendoset vetëm pas dorëzimit të përgjigjeve në pyetjet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues dhe pas shqyrtimit të dokumenteve shtesë të paraqitura."

Gjithashtu, sipas Nenit 40.12 të Rregullores 001/2022 për Prokurimin Publik:

"Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit."

Pra, në vend të eliminimit, AK ka qenë i obliguar të kërkojë sqarim nëse ka pasur paqartësi, kjo bazuar në Nenin 53 dhe Nenin 72 të LPP-së. Fotografitë e pajisjeve nuk mund të jenë bazë për eliminimin e ofertës e cila ka qenë më e lira në mesin e tenderuesve, gjë që për buxhetin e shtetit i bie favorit kursimi i fondeve publike.

V. PAPËRGJEGJËSHMËRIA E OE TË REKOMANDUAR

Kompania jonë menjëherë pas publikimit të Njoftimit mbi vendimin e AK-së (B58) nga Autoriteti Kontraktues, ka paraqitur kërkesë për qasje në dokumentacionin e aktivitetit të prokurimit, si përmes platformës elektronike të e-Prokurimit, ashtu edhe përmes postës elektronike zyrtare (e-mail) me datën 07.05.2026, në përputhje me të drejtat e garantuara nga Ligji për Prokurimin Publik.

Pavarësisht faktit se Autoriteti Kontraktues ka qenë plotësisht në dijeni për kërkesat tona, i njëjti nuk ka ndërmarrë asnjë veprim administrativ për të mundësuar qasjen në dokumentet e kërkuara deri në ditën e fundit të skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesave për rishqyrtim, duke vepruar në kundërshtim të drejtpërdrejtë me parimet themelore të transparencës, trajtimit të barabartë dhe llogaridhënies, të përcaktuara me nenin 7 dhe nenin 10 të Ligjit për Prokurimin Publik, **ku qasja duhet të jetë e shpejtë dhe e arsyeshme.**

Mosveprimi i Autoritetit Kontraktues dhe heshtja administrative në këtë fazë të procedurës krijojnë dyshime të bazuara lidhur me cenimin e integritetit dhe transparencës së procesit të prokurimit, veçanërisht duke pasur parasysh refuzimin faktik për t'u mundësuar operatorëve ekonomik shqyrtimin e dokumentacionit të ofertës së operatorit të rekomanduar për kontratë.

Në këto rrethana, kompania jonë ka dyshime serioze dhe të arsyeshme se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë për Lot-2 mund të mos i përmbushë kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë, ndërsa mungesa e qasjes së plotë në dokumentacion pamundëson verifikimin efektiv të ligjshmërisë së vendimmarrjes së Autoritetit Kontraktues.

Operatori i rekomanduar për kontratë dyshojmë se nuk plotëson këto kërkesa:

- Kapaciteti teknik dhe ose profesional -

* I njejt pretendojmë se nuk e ka menaxherin me dokumentacion të plotë, mungojnë dëshmitë përkatëse si: diploma e fakultetit (ekonomik apo juridik), trusti pensional që dëshmon përvojën e punës, kontratën e punës apo parakontratën për angazhim me pagë prej 700 euro bruto.

* I njejt pretendojmë se tek Lista e Çmimeve - çmimet për materialin higjienik i ka me çmime shumë të ulta të cilat nuk janë çmime reale të tregut dhe janë të nënvlerësuar, ku AK tek “**Lista e Çmimeve**” u ka dhënë sqarim njoftues të gjithë ofertuesve, gjë që nuk do të mundëson të bëjë furnizimin adekuat të objekteve.

* I njejt pretendojmë se **nuk posedon MSDS** të materialeve përkatësisht **etiketat e produkteve** konform kërkesës së AK.

* I njejt pretendojmë se nuk e ka menaxherin e riskut me dokumentacion të plotë, mungojnë dëshmitë përkatëse, znj. **Gentiana Krasniqi** certifikatën e ISO 31000 nuk është konform standardeve dhe është e lëshuar me datën **29.01.2026** që do të thotë se **nuk i ka 3 vite pas certifikimit.**

* I njejt pretendojmë se nuk e ka në rregull Analizën financiare **duke munguar elementet përkatëse të ligjit të punës**, kërkesë e përmendur nga AK në Dosjen e tenderit.

* I njejt pretendojmë se certifikatat e punëtorëve për siguri dhe shëndet në punë i ka të skaduara, pasi që të njejtat certifikata sipas **par.5 të Nenit 11 të Ligjit Nr. 04/L-161 Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë** kanë vlefshmëri **dy (2) vite**, andaj certifikatat e vendosura në ofertë përmbajnë datën **09.10.2019** që i bie të jenë të vlefshme deri më **09.10.2021.**

* I njejt pretendojmë se pajisjet e listuara në Aneksin 7 të dosjes së tenderit, nuk ka bashkangjitur dokumentacionin e plotë të pajisjeve, duke munguar dëshmitë ku tregojnë specifikimet e qarta të këtyre pajisjeve; shembull: **Krani për pastrimin e xhamave, i njejt ka bashkangjitur një marrëveshje për shfrytëzim të pajisjes të lidhur me një kompani të huaj, ku nuk mund të konstatohet se pajisja e bashkangjitur është me lartësi 25m siç është kërkuar, poashtu libreza e automjetit supozojmë se figuron e skaduar, nuk ka regjistrim, poashtu sipas marrëveshjes ky kran/automjet në Republikën e Kosovës do ti bëhet Trajtimi i automjeteve me targa të huaja në Kosovë rregullohet nga legjislacioni në fuqi (Neni 41 i Ligjit Nr. 05/L-132 për Automjete, dhe Neni 31 i Ligjit lidhur me Nenin 38 për të Huajt), me rregulla të përditësuara që kanë hyrë në fuqi nga marsi 2026 ku Kohëzgjatja e qëndrimit: Automjetet me targa të huaja lejohen të qarkullojnë në Kosovë maksimumi tre muaj nga data e hyrjes kurse kohëzgjatja e kësaj kontrate është 28 muaj, andaj ligjërisht nuk ka mundësi që ky automjet të përdoret sa edhe zgjat kontrata; poashtu supozojmë se pajisjet e listuara me numër rendor 8,9,10,11,13,14 poashtu nuk janë sipas kërkesave të AK-së pasi që mungon dokumentacioni i plotë ku mund të shihen specifikat dhe karakteristikat e pajisjeve që janë konform kërkesave të AK-së.**

* I njejt pretendojmë se specifikat e pajisjeve sipas numrave rendor të lartëcekur nuk kanë të dhënat specifike si: 50kw, 48v, 750kg, 700-900kg, 40kw, 9kw, 10m, në dëshmitë e dorëzuara.

Gjithashtu, sipas Nenit 7.6.3 të Rregullores 001/2022 për Prokurimin Publik:

“Zyrtari i Prokurimit sipas kërkesës për qasje në dokumente nga OE (siç përkufizohet në nenin 4, paragrafi 1, nën paragrafi 1.26 të LPP-së), pas publikimit të Njoftimit mbi vendimin e AK (B58), ofron **qasjen e menjëhershme në versionin e pastruar** dhe mban procesverbal, i cili nënshkruhet nga të dyja palët.”

Me çrast Autoriteti Kontraktues, qasjen është dashur ta lejoj ashtu siç thuhet në dispozitën e lartëcekur, menjëherë, e jo të mos e lejoj për palët e interesit.

Në mungesë të qasjes së plotë në dokumentet publike, ne nuk kemi arritur të analizojmë dokumentacionin e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, andaj ky veprim i AK-së është i qëllimshëm dhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë dëmton kompaninë tonë dhe në anën tjetër favorizon operatorin ekonomik fitues sipas AK-së.

VI. KONKLuzion

Nga sa më sipër rezulton qartë se:

- **të gjitha arsyet e eliminimit janë formale**, të paqëndrueshme dhe të pabazuara në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë,
- **janë aplikuar kërkesa të reja pas dorëzimit të ofertave**, në kundërshtim me LPP dhe Rregulloren 001/2022 për Prokurimin Publik me qëllim të eliminimit të kompanisë sonë,
- **është shkelur parimi i barazisë, transparencës, trajtimit jo të barabartë** (neni 7 i LPP-së) dhe mos-përdorimit ekonomik të fondeve publike (neni 1 dhe 6 i LPP-së).

Poashtu vlen të ceket dispozita ligjore e Nenit 40.15 të Rregullores 001/2022 për Prokurimin Publik:

"40.15 Gjatë kohës së vlerësimit të tenderit, informacione në lidhje me shqyrtimin, sqarimin, vlerësimin, krahasimin e tenderëve, pikat e dhënë, dhe rekomandimi për dhënie, nuk do tju zbulohet ofertuesve apo ndonjë personi tjetër që nuk janë të përfshirë zyrtarisht në ekzaminimin, vlerësimin e tenderëve deri sa të jete publikuar Formulari B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK."

VII. KËRKESË

Kërkojmë që Paneli Shqyrtues i OSHP-së:

1. **Të aprovojë** këtë Ankesë si të **bazuar** në ligj;
2. **Të anulojë** vendimin mbi njoftimin e AK-së;
3. **Të kthej** procedurën në **Rivlerësim**;
4. **Të sigurojë** zbatim të drejtë dhe të njëtrajtshëm të LPP-së dhe rregullores për prokurim publik.
5. **Të vlerësoj ofertat konform Nenit 59.4 të LPP-së**, në vend të eliminimit të qëllimshëm për favorizim të operatorit të caktuar.

Në të kundërtën, do të detyrohem të vazhdojmë me ankesë pranë Gjykatës kompetente për mbrojtjen e konkurrencës së ndershme dhe të barabartë.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si palë e interesit në këtë aktivitet të prokurimit na janë krijuar shpenzime të konsiderueshme në përgatitjen e dokumentacionit (ofertës) dhe pjesëve të tjera të cilat ndërlidhen me këtë aktivitet të prokurimit si: shpenzimet për përgatitjen e ankesave si në fazën e parë dhe atë të dytë, përfaqësimeve të cilat mund të ndodhin etj.

Dëmi reflekton në dëmin material dhe jo-material duke mos u kufizuar edhe në dëmin e imazhit dhe pasojave të tjera që në këtë fazë nuk janë në tërësi të konkretizuara.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit,
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”,
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim,
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-së,
- f) dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit ne përputhje me nenin 118 të LPP-së, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*